

PAULLINA SIMONS

GJETHE TË KUQE

ROMAN

BOTIMET TOENA

PAULLINA SIMONS

GJETHE TË KUQE

Roman

Përktheu nga origjinali anglisht
Platon Pulla

BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Paullina Simons
Titulli në origjinal: Red leaves
Botoi në anglisht: Flamingo, HarperCollins

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Redaktore letrare: Albina Pulla
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike: Erdita Oshafi
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817785

© Paullina Simons, 1996
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.
Kutia Postare 1420
E-mail: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al/>

Për Kevin tim,
dhe për Bob Tavitian,
jeni në zemrat tona.

PROLOG

Në parkun *Greenwich Point*, ku ajri i njelmët që vinte nga ngushtica e Long Island bëhej njësh me aromën e gjetheve të rëna, dy fëmijë po u ngjiteshin shkallëve që të çonin te disa gërmadha që dikur ishin një kështjellë. Ata fëmijë ishin vetëm, të pashoqëruar.

Para pak minutash ata kishin kaluar përpara rojës së parkingut, i cili, me sa dukej, i njihte mirë dhe, duke buzëqeshur, u bëri më shenjë të vazhdonin. Parku ishte i madh dhe kishin shumë rrugë për të bërë derisa të arrinin aty ku donin. Por dielli ndriçonte dhe bënte ende vapë. Vogëlushja mbante një çantë me ngjyrë të bardhë dhe të kuqe, ndërsa djaloshi mbante një kapelë bejsbolli dhe një balonë. I ranë përqark skajit perëndimor të gjirit dhe afër bregut gjetën një tavolinë që përdorej për piknik. Vogëlushja dëshironte t'i hiqte menjëherë këpucët dhe të ndiente guralecët e lëmuar poshtë këmbëve të saj, por djali nuk ishte dakord. Donte që fillimisht të hanin. Vogëlushja psherëtiu dhe u ul. Hëngrën. Vajza nuk i mbajti mëri për shumë kohë - ishte e lumtur që gjendeshin aty.

Pas pak flaku atletet e saj të bardha prej lecke, u ngrit në këmbë dhe e gëzuar u nis drejt ujit. Shumë prej guralecëve të lëmuar ishin të mbuluar nga myshqe rrëshqitës, por asaj nuk i bënte përshtypje. Mblodhi disa prej midhjeve që ishin të shpërndara në breg dhe i kontrollonte. Ato që ishin të hapura, i flakte përsëri, teksa i erdhën ndër mend fjalët e të atit: “Nëse janë të hapura, do të thotë se kanë ngordhur dhe nuk janë të mira”. I hodhi të gjitha midhjet e zeza me guaskë të mbyllur në çantën e saj. Djali solli edhe disa gaforre dhe i vendosi dhe ato në çantën e saj. Për pesëmbëdhjetë minuta me radhë përpiqeshin të dallonin nëse ato format e lëvizshme në gji, rreth pesëdhjetë metra larg, ishin dallgë

apo vidra. Vajza tha se janë vidra, por djali qeshi. “Janë dallgë, - i tha, - thjesht dallgë”, por ajo nuk u bind. Nga larg dukeshin sikur e kishin kurrizin të zi dhe kridheshin në ujë. Sigurisht që nuk zhvendoseshin, kështu që djali ndoshta kishte të drejtë, por ajo nuk donte ta pranonte. Ai djalë ishte gjithmonë kaq i sigurt në vetvete! Për më tepër, do të ishte argëtuese të mendonin se kishin parë vidra në parkun e tyre.

Vajza iu drejtua përsëri shtegut. Djali e parakaloi duke vrapuar dhe, teksa kalonte në krah të saj, i tërhoqi flokët. Ajo tentoi t’i shmangej dhe zmadhoi hapin duke kërcyer me vështirësi mbi gurë.

Ishte një vogëlushe e lezetshme. Flokët e saj të shkurtër ishin të prerë bukur dhe të krehur me kujdes. Bluza e bardhë, e qepur me merak, ishte e hekurosur, po ashtu edhe pantallonat e saj xhins, të hekurosura me vizë. Xhaketa e saj e bardhë nuk kishte asnjë njollë te mëngët, siç u ndodh rëndom fëmijëve të moshës së saj. Atletet e saj prej lecke ishin të bardha borë dhe lidhëset dukeshin si të reja. Luksi i vetëm fëmijëror, që ishte në kontrast me këto dhe që vogëlushja ia lejonte vetes, ishte të hiqte këpucët dhe të ecte zbathur mbi algat e rrëshqitshme.

I gëzohej faktit që do të bënin piknik dhe që do ta lëshonin balonën nga ana tjetër e parkut të madh. E vetmja gjë që e mërziste pak, ishte ajo që do të bënin derisa të vinte ai moment. Ajo dëshironte që tashmë të kishin mbërritur te livadhi i gjelbër dhe të lëshonin litarin. Kur balona të ishte ngjitur lart në qiell, vajza do ta linte të lirë litarin dhe djali do të thërriste: “Më lart! Më lart! Më lart!”.

Vjeshta ishte stina e saj e preferuar, veçanërisht këtu, ku era e fortë dhe e njelmët frynte përmes gjetheve të kuqe të lisave të bardhë.

- Dëshiron të shkojmë drejt e te livadhi? - i thirri djaloshi duke iu marrë fryma dhe zëri iu ndërpre. Ajo u ndal për të veshur këpucët - u ndal edhe ai, u kthye dhe iu afrua.

- Në vend që të bëjmë çfarë?

- Në vend që të shkojmë te kalaja, - tha vajza.

Ai e vështroi me ngulm.

- Dakord, - tha më në fund duke ngritur supet. - Por besoja se të pëlqente kalaja.

Nuk iu përgjigj menjëherë, dhe pastaj tha sikur po kërkonte ndjesë:

- Më pëlqen. Thjesht jam e lodhur, kjo është e gjitha.

I bëri me shenjë që të vazhdonin.

- Hajde, mos bëj si foshnje!

Ajo u përpoq të mos bënte si foshnje.

Vazhduan të ecin nëpër monopat, midis lisave të lartë dhe krenarë, i ranë përquark tendës ku ishin varkat dhe arritën te muri ndarës.

Djaloshi, me një të kërcyer, u gjend majë murit - ishte vetëm gjysmë metër i lartë, por ndante shtegun nga uji që ndodhej në anën tjetër. Sa herë që vajza e vogël i ngjitej murit, kishte frikë se do të binte në ujë. Dhe nëse binte, kush do ta shpëtonte? Ai jo, me siguri - nuk dinte not. Dhe ishte e pamundur të mbaheshin përdore, muri nuk ishte mjaft i gjerë. Por jo, ajo *duhej* të hipte, që t'i tregonte se nuk kishte frikë.

Por kishte frikë. Megjithatë, ishte e entuziazmuar. Sqetullat ndërkohë kishin filluar t'i djersinin.

- Nuk dua ta bëj këtë, - pëshpëriti, por ai nuk e dëgjoi, ngaqë ndërkohë kishte ecur shumë përpara, në drejtim të fortesës. *Atë* moment i dha urdhër vetes të mos dridhej dhe, duke psherëtirë, u ngjit majë murit.

Ajo që kishte mbetur nga fortesa, ishte një beden, një vend luftimi, prej nga ku dukej ngushtica e Long Island nga lart. Pemët dhe shkurret e dendura, natyra përreth, mërmërisnin me zë të ulët dhe tregonin për lavdinë e dikurshme të fortesës.

A thua se ishte një fortesë e dalë prej përrallave, e harruar, me kalorës, princesha dhe parzmore. Me shërbëtorë dhe veshje të bardha. Me dhoma sekrete, kalime sekrete dhe jetë sekrete. "Edhe unë kam sekrete", mendoi vajza e vogël, duke hedhur disa hapa të pasigurt mbi mur. Princesha me veshjen e saj të bardhë dhe këpucët që i shkëlqenin, ruante sekrete.

- Më prit! - thirri me zë të lartë vogëlushja dhe u turr përpara.
- Më prit!

PJESA E PARË

VAJZA ME ÇIZME TË ZEZA

Vrullit tonë më të fuqishëm,
tiranit brenda vetes sonë,
i përulet jo vetëm arsyeja jonë,
por edhe ndërgjegjja jonë.

Frederik Niçe

KAPITULLI 1

E diel

Katër miqtë, kishin filluar të luanin basketboll, dy kundër dy të tjerëve, vetëm pak minuta më parë, por Kristina Kim tashmë ishte djersitur. Thirri “*time out!*” dhe kapi një peshqir. Arbitri, Frank Absalom, dhe Aristoteli, qeni i saj labrador, e vështruan që të dy të habitur. Ajo bëri një grimasë dhe ua ktheu vështrimin.

- E bëra nxehjen, dakord?

Franki, i zhytur brenda palltos, me kapuç skiatorësh në kokë dhe mbuluar batanije, po qeshte.

- Ç’po ndodh? - e ngacmoi ai. - Nuk je në formë?

Aristoteli dihashte, duke nxjerrë frymëmarrjen e tij prej qeni në ajrin e akullt. Për aq sa zgjaste loja të dielave pasdite, e kishte të ndaluar të lëvizte, dhe ai u bindej duke tundur vetëm bishtin, në një mënyrë rebelimi prej qeni. Xhim Sho, Koni Tobias dhe Albert Maplthorpe u afruan. Kristina nxori një shishe uji mineral nga çanta, e hapi, lagu fytyrën dhe pastaj e fshiu. Ajo ditë fundnëntori ishte e akullt, por ajo e kishte fytyrën të skuqur.

Xhimi e pickoi me përkëdheli në zverk.

- Kris, ç’po ndodh me ty? Je mirë?

- Hajde tani! - ia bëri Alberti. - Çfarë po bën? Po përpiqesh të fitosh kohë?

Përkundrazi, Kristina donte që koha të rridhte më shpejt, të fluturonte deri në orën një, kur do të takonte Houard Kimin tek taverna e Piter Kristianit. Donte që të mbaronte punë me atë drekë dhe e shqetësonte aq shumë kjo çështje, saqë nuk mund të mendonte për asgjë tjetër.

- Nuk jam në formë, - Kristina pranoi vërejtjen e Frankit, duke injoruar vërejtjen që i bëri Alberti. E lejoi Xhimin t’ia fërkonte qafën. - Të shtunën që vjen fillon sezoni dhe unë kam hallet e mia.

- E ke gabim, - i tha Koni. - Je për mrekulli. Dje ishe për bukuri. Kristina tundi kokën me indiferentizëm, duke shpresuar se askush nuk do ta vinte re fytyrën e saj të skuqur.

- S'besoj, dje bëra vetëm një demonstrim.

- Krisi, dje shënove dyzeteshtatë pikë!

- Po, po, e di. Por skuadra e Kornelit nuk i kishte mobilizuar të gjitha forcat.

- Edhe të donte, nuk do të kishte mundësi, - ndërhyri Xhimi, që vazhdonte t'u bënte masazh supeve.

- Franki, sa vajti ora? - pyeti Kristina.

- Dymbëdhjetë e shtatë minuta.

- Ejani, djema, luajmë, - tha Kristina. - Po skuadrat?

Loja e parë ishte një çift kundër një çifti tjetër. Alberti me Konin kundër Kristinës dhe Xhimit.

- A je mirë, e dashur? - e pyeti Xhimi duke e prekur në sup.

Ajo e vështroi mendueshëm dhe përkëdheli faqen e tij të ftohtë.

- Nuk kam gjë. Thjesht po bëj nxemje.

Koni po dridhej.

- Edhe unë jam djersitur, - tha.

Duke e vështruar me sy të perënduar, Kristina i buzëqeshi, ndërkohë që po mendonte: "Po tallet me mua". Koni nuk ia ktheu buzëqeshjen. Duke kafshuar buzët, Kristina u tha Albertit dhe Konit:

- Doni avantazh pikësh?

Ata i buzëqeshën paksa me ironi.

- Vafsh në djall me gjithë avantazhet e tua! Lëshoji flokët në fytyrë dhe ne nuk duam asgjë tjetër. Gjithsesi, do të fitojmë, - tha Alberti. Koni nuk bëri asnjë koment.

Humbën me rezultatin 20-16.

Kristina ishte një vajzë e gjatë, me këmbë të gjata dhe flokë të dendur të zinj, që i binin në fytyrë dhe i arrinin deri në mes të supeve. Nuk i pëlqente t'i lidhte flokët mbrapa. Flokët e saj të zinj tërhiqnin vëmendjen e skuadrës kundërshtare dhe, gjatë lojërave kualifikuese të *Ivy League*, të ligës së nëntë universiteteve më të mira të pjesës verilindore të SHBA-së, e kishin urdhëruar

që t'i lidhte. Ajo i lidhte, por derisa të përfundonte loja, flokët zgjidheshin vetë dhe, sido që t'ia bënte ajo, i binin mbi fytyrë.

Por këtu, në rrugicën para shtëpisë së vëllazërisë së Frankit, *Phi Beta Epsilon* - një nga shtëpitë që binin më pak në sy në rrugën *Webster*, Kristina nuk i lidhte kurrë flokët. Luanin në një tabelë të vjetër, që kishte një kosh të ndryshkur pa rrjetë. Por Kristinës nuk i bënte përshtypje. Loja dy kundër dyve ishte një stërvitje shumë e mirë për të, e bënte më të shpejtë.

Por sot veçse, duart i rrëshqisnin dhe topi i binte vazhdimisht dhe, si rezultat, ia merrte edhe Koni madje, lartësia e shtatit të së cilës nuk i kalonte një metër e gjashtëdhjetë e pesë. Kristina u përpoq të kalonte topin nga njëra dorë tek tjetra prapa supeve, por nuk ia doli - Koni dhe Alberti ia morën topin dhe gjuajtjen. Qeshën të gjithë me të, por Kristinës mendja i rrinte te Houardi - nuk ua ktheu të qeshurën. Zakonisht mund të rrotullohej në ajër teksa hidhej për të shënuar kosh. Por jo sot, megjithëse ishte lojtarja më e mirë nga ata të katërt.

Sa herë që shënonin kosh, Kristina përplaste pëllëmbën e saj me të Xhimit dhe ia mbante për një moment gishtërinjtë, ashtu siç bënte gjithmonë. Ai e lejonte, por në momentin kur ajo i lëshonte gishtërinjtë e tij, edhe ai ia lëshonte të sajat.

Kristina përtypte çamçakëz teksa luante. Një moment, kur preku tokën me forcë pas një kërcimi, kafshoi gjuhën. Pështyu çamçakëzin të përzier me pak gjak.

Franki fërshëllente për personale dhe shënonte pikët në një bllok të vogël. Duke përtypur çamçakëz, rrinte ulur mbi një batanije të palosur, me gjunjët të mbledhura në gjoks. Kapuçin e kishte ulur deri te veshët.

Kur të gjithë iu afruan, Kristina e pyeti sa ishte ora.

- Pesëmbëdhjetë minuta kanë kaluar nga hera e fundit kur më pyete, - u përgjigj Franki. - Siç e di, çdo lojë zgjat pesëmbëdhjetë minuta. Unë kështu e kuptoj. E ke me nxitim?

- Jo, jo, - iu përgjigj shpejt Kristina, duke i hedhur ujë fytyrës. - Ejani, vazhdojmë lojën!

- Na lër të marrim frymë! - ngriti zërin Koni. - Vetëm pesë minuta.

- Jo, tani kam marrë vrull, - iu përgjigj Kristina. - Skuadrat? Koni ia nguli vështrimin Kristinës.

- Të them të drejtën, Kristina, nuk e di. Çfarë bëjmë zakonisht kur fiton ti?

- Vajzat kundër djemve? - pyeti Kristina.

- A nuk është ide e mirë?

Kristina nuk kishte ndër mend t'ia lejonte Konit që ta frikësonte me atë shprehje sarkastike dhe të zemëruar.

- Bukur! Keni nevojë për handicap? - Handikapi ishte vetë Koni, por Kristina nuk do ta thoshte kurrë këtë.

Xhimi e shtyu lehtë me sup Kristinën drejt fushës së lojës.

- Diçka më thotë se këtë lojë nuk do ta fitojmë ne, - i tha duke e puthur lehtë në faqe. Ajo e ktheu fytyrën nga ai dhe u përpoq ta puthte në buzë, por ai u largua. Vështrimi i tij ishte i akullt.

“Është xhindosur me ato që ndodhën mbrëmë”, mendoi Kristina. “Më vonë. Më vonë.”

Kristina me Konin fituan mbi skuadrën e Xhimit dhe Albertit me rezultatin 18-16.

- Për pak do të kishit fituar, - tha Kristina kur kishte mbaruar loja.

Xhimi nuk kishte luajtur mirë. Vraponte pak më ngadalë, e hidhte topin pak më ulët dhe nuk përpiqej t'ia merrte topin Kristinës, dhe as e bllokonte. Kristina pothuajse do të betohej se Xhimi kërciste dhëmbët duke e parë tek luante, por më vonë këtë përshtypje ia faturoi fantazisë së saj të sëmurë. “Po atëherë, përse i kafshon buzët sa herë që driblojmë topin?”, mendoi Kristina.

- Lëre mënjane tolerancën, zonjushë All-Ivy, - i tha Xhimi. - Kur të mbarojmë këtej, do të shkojmë të vrapojmë një milje dhe atëherë shohim se kush do të fitojë.

Kristina besonte se në ato momente do të mund të vraponte një milje në disa sekonda. “Sa do të ketë vajtur ora?”, mendonte.

- Franki, sa është ora?

Nga aty ku ishte ulur, Franki ngriti sytë dhe i tregoi orën. Dymbëdhjetë e dyzet e tri minuta. Kristina ishte mbuluar e tëra me djersë. Edhe shtatëmbëdhjetë minuta akoma.

Për pesëmbëdhjetë minuta Kristina me Albertin fituan ndaj Konit dhe Xhimit 40-8. Kristina vraponte pas çdo pasimi, bllokonte edhe Konin madje, të cilën zakonisht e linte të qetë. Thua se, sa më shpejt të vraponte, aq më shpejt do të rridhte edhe koha.

- Lojë e bukur, - ia bëri Kristina duke gulçuar.

Koni ia ktheu:

- Në të vërtetë, preferoj më mirë të ndjek një lojë basketbolli sesa të luaj vetë. Veçanërisht kur Krisi fiton dhe me Harvardin.

- Dakord, por sporti të pëlqen, dhe kjo është e vetmja gjë që ia vlen, - i tha Kristina.

- Vërtet? Me një fjalë, e vetmja gjë që ia vlen, - u përgjigj Koni me njëfarë keqdashjeje dhe duke e vështruar Kristinën, - është fakti se më pëlqejnë sportet?

- Sigurisht, - ia bëri Kristina pa e dhënë veten.

Ndërhyri Alberti.

- Jo, - tha, duke përqaftuar Konin dhe duke buzëqeshur me nënkuptim. - Ka dhe një mori gjërash të tjera që ia vlejnë. - Koni buzëqeshi e kënaqur dhe Kristina ngriti çantën e saj të shpinës nga toka.

- Takohemi më vonë.

- Prit! - thirri Koni.

Koni, duke iu afruar Kristinës dhe duke ulur zërin, me vështrime plot nënkuptim në drejtim të Albertit, tha:

- Kujtoja se do të më ndihmoje, e di ti... me... e di ti... me...

- Ah po, me tortën, - i pëshpëriti Kristina.

- Shëët...

- Shëëët... më fal! - Kristina foli me zë të ulët, por truri i punonte me kaq shpejtësi, saqë nuk e dëgjonte veten duke folur. - Më duhet të iki tani. "Tani, tani, tani", i thërriste një zë i brendshëm. - Do të kaloj më vonë, dakord?

- Kristina! Arrat, lajthitë, na duhet t'i bluajmë imët të gjitha. Do të na duhen orë pambarim. Pastaj kemi edhe kremin - eja tani.

Duke u përkulur te veshi i Konit, Kristina i tha:

- Kam për të të thënë diçka në lidhje me këtë...

Pikërisht në atë moment iu afruan Xhimi me Albertin dhe Kristina nuk gjeti rastin t'i thoshte Konit se Alberti i përbuzte frutat e thata, veçanërisht lajthitë.

- Çfarë po gatuani ju të dyja këtu?

- Asgjë, asgjë, - u përgjigj me të shpejtë Kristina.

Koni ngriti duart lart dhe nuk foli. Xhimi qeshi, dhe Kristina u mat të largohej.

- Do të flasim më vonë, - u thirri dhe, ndërkohë, me bisht të syrit pa që Alberti po e vështronte me ngulm. Ajo hodhi vështrimin në drejtim tjetër dhe fshiu fytyrën e saj të lagur.

- Prit! - Xhimi e arriti Kristinën: - Hej! - Ecën pa folur gjatë bulevardit *Webster* deri te *North Main Street*, përmes pemëve të zhveshura nga gjethet. Disa studentë po qëndronin tek trotuari i përparmë i ndërtesës ABC dhe diskutonin.

Kristina shpresonte që Xhimi nuk do ta vinte re se sa shpejt po ecte dhe nuk do t'i bënte pyetje për natën e mëparshme. Nuk i bëri, por ajo që i tha ishte edhe më keq.

- Dëshiron të drekojmë së bashku? - e pyeti Xhimi.

- Të drekojmë? - Kristina e humbi toruan. Sigurisht që nuk e mendonte se do të zhdukej pas lojës së tyre javore pa e marrë vesh Xhimi, por gjatë atyre pothuajse tre vjetëve që dilnin së bashku, Kristina nuk i kishte folur kurrë Xhimit për Houardin dhe as që kishte ndër mend ta bënte tani që do të kthente një faqe të re në jetën e saj. U kthyen djathtas te cepi i *North Main Street*.

- Xhim, duhet të shkruaj atë tekstin në lidhje me dënimin me vdekje për *Review*. Edhe tani jam vonë.

Ai e pickoi me përkëdheli në qafë teksa po ecnin.

- Ke pak kohë.

- Ashtu? Të tjera gjëra thoshe dje.

- Dje? - Ai hoqi dorën. - Kristina, dje nuk u takuam, - i tha me nënkuptim, dhe Kristina u skuq.

- Po u pamë. Dje në mëngjes.

Xhimi tundi kokën në shenjë mohuese.

- Jo. As në mëngjes. As dje në darkë.

Kristina u mundua të përmbante një psherëtimë, megjithatë i doli përmes buzëve të saj të thata dhe të shtrënguara.

- Ah, po, dje në darkë. Dje në darkë shkova te *Gjethet e Kuqe*.
- Te *Gjethet e Kuqe*, ë? - ia bëri Xhimi. - Sa shpesh të kërkojnë të punosh të shtunave në darkë?

Gjethet e Kuqe ishte një institucion për vajza adoleshente shtatzëna, ku Kristina punonte qysh atëherë kur ishte në vit të parë.

- Zakonisht nuk e bëjnë. Por Evelina, e di ti...

- Po, e njoh Evelinën. Çfarë ka ajo?

- Është shtatzënë...

- Vërtet? - ia bëri Xhimi. - Por kjo nuk është diçka e pazakontë për *Gjethet e Kuqe*, apo jo?

- Dhe ka rënë në depresion, - vazhdoi Kristina pothuajse pa u ndalur. - Kishte nevojë për mua... kështu që ndenja aty.

- Fjete aty?

- Po. Kam fjetur dhe herë të tjera aty.

- Shumë mirë.

Në tonin e zërit të tij vazhdonte të ndihej dyshimi, por në fytyrë i dallohej lehtësimi. Kristina qeshi dhe tha:

- O Zot, ke marrë një pamje, thua se sapo të thashë që ke fituar lotarinë! - I shpupuriti flokët pa ndaluar së ecuri.

- Jo, - iu përgjigj ai me një shprehje fytyre pa asnjë lloj emocioni. - Kjo është shumë më e mirë.

Kristina pothuajse dridhej prej ankthit. Lavdi Zotit që ishin duke ecur, dhe Xhimi nuk i dallonte këmbët e saj që mezi po e mbanin! Ajo i kapi dorën. Sapo kishin kaluar përpara bibliotekës *Baker* dhe po i afroreshin *Tuck Mall*-it, ku banonin ata të gjithë. Ajo donte që Xhimi ta linte aty dhe të mos e shoqëronte gjatë rrugës *Main*.

- Ke ftohtë? - e pyeti Xhimi.

- Jo, përse po më pyet? - iu kthye Kristina duke tërhequr dorën dhe duke fshirë djersën në fytyrë. - Jam si llavë e nxehtë.

- Po të dridhen këmbët.

Kristina kishte veshur tuta të zeza, që i rrinin pas trupit, dhe një bluzë jeshile të *Dartmuthit*.

- Ke të drejtë, po ngrij nga të ftohtit, - i tha.

Duke e vështruar me kujdes, Xhimi i tha:

- Hej! Çfarë po ndodh me ty?

- Asgjë, - iu përgjigj shpejt e shpejt ajo, me një buzëqeshje sa më të gjerë të mundshme.

- Absolutisht asgjë.

Vuri re që nuk po i besonte. Fytyra i mori një shprehje edhe më dyshuese.

- Eja, shkojmë të hamë së bashku, - propozoi Xhimi.

- Nuk mundem, Xhimbo, më fal! Më duhet të punoj para se të vij në pushimet e Festës së Falënderimeve. Më presin jashtë mase shumë gjëra që duhen bërë.

- E po mirë, - ia bëri ai duke psherëtirë. - Atëherë, po vij bashkë me ty në zyrë. Kam edhe unë shumë punë për të bërë aty. Xhimi ishte kryeredaktor i gazetës konservatore *Review* të kolegjit të Dartmuthit.

- Oh, Zot! - foli me zë të lartë Kristina. Po i sosej durimi. - Xhim, të lutem! Një apo dy orë më duhen vetëm. Kam nevojë të ulem dhe të mendohem, thjesht të qëndroj vetëm dhe të vë rregull në mendimet e mia. Dakord?

Ai ndaloi së ecuri, u ndal edhe ajo, por duke vazhduar të bëjë në vend-numëro.

- Do të shihemi më vonë? - e pyeti ai.

- Xhimbo, - ia bëri Kristina, duke ia dalë që t'i jepte një nuancë të ëmbël zërit të saj. Ishte kaq e madhe indinjata dhe shqetësimi i saj, sa që ai emër përkëdhelës u shqiptua shpejt dhe me zë të ngjirur, thua se po e përkëdhelte dhe po e pështynte njëkohësisht. U kollit që të pastronte fytin.

- Xhim, natyrisht që do të shihemi. Do të studiojmë së bashku në katër, harrove? Në orën dy më duhet të shkoj në stërvitje. Do të flasim, dakord?

- Përse nuk zhvendosesh për të banuar në stadiumin *Lind*? - ia bëri me inat Xhimi. - Përderisa përherë gjendesh aty?

- Xhim, më duhet të shkoj në stërvitje. Ti e di këtë. Nuk jam bërë kampione vetëm falë talentit tim. Buzëqeshi.

- A ndikon kjo në punën tënde? - Toni i zërit të tij tregonte pakënaqësi.

- Dakord, nuk pres që të dal me rezultate të shkëlqyera këtë semestër. Nëse kjo është ajo që do të mësosh.

Ai tundi kokën dhe në vijim, thua sikur i erdhi diçka ndër mend, i tha:

- E di që mbrëmë nga nuk të kërkova që të të gjeja? Gjithandej.

Ajo nuk tha asgjë dhe Xhimi vazhdoi:

- Vajta madje dhe në bibliotekë.

Duke zgjatur dorën, Kristina preku fytyrën e tij.

- Më vjen keq! Duhej të të kisha thënë që isha te *Gjethet e Kuqe*.

- Uroja të ma kishte thënë. Ora kishte vajtuar pothuajse një kur më zuri gjumi. I bija vazhdimisht telefonit te dhoma jote.

- Në orën një, ë? - Kristina ia doli të vërë buzën në gaz. - Domethënë, dy orë pothuajse pas orës kur bie zakonisht për të fjetur, apo jo?

- Ha-ha, - ia bëri Xhimi.

- Më duhet të iki, Xhimi. Do të flasim në vonë, - tha Kristina.

Ai u përkul dhe e puthi, edhe ajo ia ktheu puthjen dhe u largua duke shpejtuar hapin derisa filloi të vrapojë. Lidhëset e atleteve të saj të grisura *Adidas* ishin liruar dhe Kristina u ndal një moment për t'i lidhur, duke e lëshuar përtokë çantën që kishte me vete. Ajo mori rrugën nga *McNutt Hall* drejt kafenesë *Colins* dhe atëherë u kujtua për çantën. U kthye mbrapsht, e mori dhe filloi të vrapojë nën tendat jeshile të *Main Street*-it, direkt drejt restorantit nëntokësor të Piter Kristian-it.

“Oh, Zot i madh, po fillojmë”, mendoi Kristina, duke marrë tri herë frymë thellë dhe u fut te restoranti që ishte në gjysmerrësirë.

- Më fal që u vonova, - tha Kristina dhe u ul përballë Houardit. Ai buzëqeshi me mirësjellje.

- Nuk u vonove dhe aq shumë, - iu përgjigj ai, duke i shqiptuar fjalët me ngadalë e me saktësi dhe duke vështruar orën e tij. - Vetëm pesëmbëdhjetë minuta. Hodhi dy sheqer te kafeja e saj dhe shtoi pak qumësht. Si gjithmonë, Kristina mendoi se sa e çuditshme, por dhe e pazakontë, ishte kur e dëgjonte duke folur me një anglishte kaq të përkryer. Ajo u përkul për ta puthur.

- Përse je me djersë? - e pyeti ai duke ia fshirë faqen.
- Po luanim basketboll, dhe unë djersij shumë. - Ajo buzëqeshi, mori një pecetë dhe fshiu fytyrën. Houardi rrinte dhe vetëm e shikonte.

Kristina piu një gllënjë kafeje dhe shtrembëroi fytyrën.

- Kafeja është ftohur, - tha dhe lëshoi filxhanin. Nuk donte që Houardi të shikonte që gishtërinjtë po i dridheshin.

- Dukesh sikur *je* e ftohur, - i tha ai.

- Houard. - Kristina buzëqeshte e kënaqur. - Po bën lojëra fjalësh tani?

- Përse u habite? Ti e di që kam sens humori, - iu përgjigj me seriozitet ai.

- E di, Houard, - tha Kristina duke ia ledhatuar me butësi dorën që nga ana tjetër e tavolinës. - E di këtë.

- Je ftohur me të vërtetë, apo nuk është kështu?

- Po, po, jam ftohur. - Në fakt, nuk ishte e vërtetë, por e dinte që kishte rëndësi për Houardin të tregonte interes për të.

- Ku e ke pallton? Ke veshur tuta?

- E harrova pallton. - Ajo ngriti supet, thua se kjo gjë nuk kishte rëndësi.

- Ti vazhdon të bësh me kokën tënde.

- Në lidhje me çfarë?

- Refuzon të vishesh në mënyrë të përshtatshme, sipas stinës së dimrit.

- Mendoj se kjo gjë më gjallëron.

- Por edhe viruset mund të jenë shumë gjallërues. Streptokoku. Pneumonia.

- Kurrë nuk kam pasur ndonjë gjë prej këtyre, - i tha Kristina.

- Ai po e bezdiste me mënyrën si e trajtonte, duke luajtur rolin e dados, por, gjithsesi, nuk prishte ndonjë punë. - Gjithmonë kam qenë e fortë si një kalë.

Pritën të jepnin porosinë para se të hynin në temë. Kristina donte të porosiste një sallatë me një salcë mustarde pikante dhe të shijshme, por ishte vakti i parë për atë ditë - përveç disa *crackers* - dhe nuk donte të konsumonte mustardë dhe uthull në atë orë. Në vend të kësaj, porositi kek me karota.

U mundua ta kontrollonte veten dhe të mos nervozohej. Por nervat i kishte të tendosura. Natën e kaluar nuk kishte fjetur dhe aq mirë, dhe këtë mëngjes të bukur ishte zgjuar në orën shtatë. Kodrat e Vermontit me pemët pa gjethe shkëlqenin atë ditë me diell, por tani, e vetmja gjë që ndiente ishte shqetësim, teksa mendonte për Xhimin e tronditur dhe për Houardin e durueshëm, të përmbajtur dhe të sjellshëm, që po e vështronte me ato sytë e tij të qetë, që nuk qeshnin mbrapa xhamave të syzeve të tij me skelet të zi.

- Po ti, si je? - e pyeti ajo, duke u përpjekur për t'u qetësuar.

- Mirë, Kristina, gjërat po ecin shumë mirë. Kemi shumë punë.

- E po, kjo është gjë e mirë, - ia ktheu ajo. Ai nuk iu përgjigj. - Apo nuk është kështu? Është gjë e mirë të kesh shumë punë. Do të duhet të jesh shumë... i kënaqur... që ke kaq shumë punë. - E ndiente që po i jepte gojës pa ndonjë qëllim. - Oh, Zot i madh! - Ke shumë çështje interesante?

Ai e vështroi për një moment.

- Sa interesante mund të jenë çështjet tregtare? Le t'i shohim këto letra, Kristina.

Kristina, në mënyrë nervoze, nxori një dosje të verdhë nga çanta e saj. Teksa po ia jepte, ajo i tha:

- Më duket se gjithçka është në rregull.

Houardi ndaloi një moment para se ta hapte.

- Është gjithçka në rregull? Nuk jam kaq i sigurt.

Kristina sikur e keqkuptoi dhe ia ktheu: - Me të vërtetë që gjithçka është korrekte.

Houardi u hodhi një vështrim dokumenteve dhe i shtyu mënjane.

- Kurrë nuk na u dha rasti që të diskutojmë për këtë. Ka ndodhur gjë?

Diçka *kishte* ndodhur. Gjyshja e Kristinës kishte vdekur. Por Houardi nuk e dinte këtë. Dhe as që do ta merrte vesh.

- Thjesht besoj se është më mirë kështu, kjo është e gjitha, - u përgjigj Kristina duke luajtur me pirunin e saj. Provoi kremin me djathë mbi kekun e karotës. Ishte i mirë, por ajo thjesht nuk kishte më uri.

- Është me të vërtetë më mirë?

- Sigurisht.

- Përse? Përse kërkon divorc në mënyrë kaq të papritur?

Ai kishte veshur kostum dhe dukej kaq simpatik dhe i afërt, saqë befas Kristina u mërzit. “Kjo do të thoshte vallë se nuk do ta shoh më?”, mendoi ajo. “Jam ambientuar kaq shumë me mendimin se ai ekziston.”

Duke ngritur supet, Kristina lëshoi pirunin. Kafeja ishte e ftohtë, keku kishte shumë djathë dhe stomakun e kishte bosh.

- Nuk ishte diçka e papritur. Mendoj se tashmë kishte ardhur momenti.

- Përse?

- Houard, ngaqë pres të mbush njëzet e një vjeç, ngaqë dua të vazhdoj jetën time. Çfarë do të bëhet, domethënë, nëse unë do të dua të martohem me dikë? - Ndaloj së foluri. - Çfarë do të bëhet nëse *ti* do të duash të martohesh me dikë?

- Ekziston dikush me të cilin dëshiron të martohesh, Kristina?

- Ende jo, por kush e di? - Buzëqeshi. - Princi i Kaltër mbase më pret te cepi i rrugës.

- Hëm... Unë kujtoja se Princi i Kaltër ishte Xhimi.

Kristina u kollit.

- Atë kisha në mendje. Xhimin. - Ajo gëzohej për faktin që po flisnin. Duart e saj gjetën qetësinë. Tani nuk ndiente më atë zagushi përbrenda.

Houardi u përkul në drejtim të saj, uli edhe më zërin e tij, që, edhe pa e ulur, ishte i ulët dhe, me qetësi, e pyeti:

- Ideja *jote* ishte kjo?

Kristina u tërhoq pak mbrapa nga tavolina. Ishin ulur në një cep, mbrapa shkallëve dhe salla, si qilar, ndriçohej nga një dritë e zbehtë.

- Houard, nuk e di për çfarë e ke fjalën.

- Të pyeta nëse kjo ishte ideja *jote*.

- E di se çfarë pyete. Thjesht nuk e di se çfarë nënkupton.

- Kristina, është një pyetje, së cilës mund t’i japësh përgjigje me një “po” ose me një “jo”.

- Po ti kujton se gjithçkaje mund t'i përgjigjesh me një "po", ose me një "jo", - u përgjigj ajo e acaruar.

- Pothuajse gjithçka kështu është. - Këtë frazë e shqiptoi me lehtësi. - Le ta provojmë edhe një herë. Kristina, ideja jote ishte kjo?

Ajo u ndie e detyruar t'i përgjigjej. - Çfarë nënkupton me këtë? - ia preu hovin ajo.

- Nënkuptoj nëse e ke menduar vetëm ti, apo dikush tjetër të propozoi që të marrim divorc.

Duke mos qenë e aftë t'i përgjigjej, Kristina lëshoi frazën:

- E kush tjetër do të mundej... - por pastaj ndaloi. Houardi e vështronte në sy dhe, ngaqë ajo e dinte se çfarë nënkuptonte me *saktësi*, mendoi se nuk kishte kuptim të vazhdonte të shtirej më. Kështu që gënjeu. - Po, Houard, ideja ime ishte.

Houardi i hodhi një vështrim apatik, por mbrapa syve të tij seriozë ngjyrëkafe, dallohej njëfarë përzemërsie.

- Haje kekun, - tha më në fund Houardi me zë të butë.

- Kujt i intereson keku? - ia bëri ajo me një fytyrë të thartuar.

- Unë interesohem për divorcin.

Kristina mori frymë thellë.

- Houard, - i tha, - e di. Por besomë, gjithçka do të shkojë mirë.

- Kristina, e kam të pamundur ta besoj këtë.

- Përse?

- Kristina, yt atë më kërkoi që të kujdesem për ty.

- Nuk ta kërkoi, Houard, thjesht të tha.

- E ke gabim. Bëmë një marrëveshje.

- Po, dhe besoj se ti respektove marrëveshjen për aq sa të takonte. Por, së pari, nesër mbush njëzet e një vjeç dhe, së dyti, im atë ka vdekur tashmë. Ka ardhur momenti, Houard.

- Marrëveshja është marrëveshje. Nuk përfshimë kushte në lidhje me moshën apo për vdekjen e tij në marrëveshjen tonë.

- Oh, Houard, - psherëtiu Kristina dhe pastaj shtoi ngadalë: - Lëre më mirë.

- Nuk mundem, - u përgjigj ai.

- Të lutem, mos u shqetëso për mua! Gjërat do të shkojnë për mrekulli, të premtoj. - Vetë Kristina donte që ta besonte këtë.

Ai e hodhi vështrimin gjetkë dhe, duke tundur kokën, i tha:

- Papritur.

- Jo aq papritur! Pas pesë vjetësh. Hajde tani, është më mirë kështu. Për ty nuk kam qenë asgjë më shumë se sa një mjet për të arritur një qëllim.

Nga shprehja e fytyrës së tij, Kristina e kuptoi se e kishte lënduar. Fjalët e saj duhej ta kishin bërë të ndihej tmerrësisht keq.

- Më fal, - shpejtoi të thoshte. - Ti e di se çfarë nënkuptoj. Je njeri i mirë, meriton diçka më të mirë. Shpresonte se po thoshte gjërat që duheshin thënë, por ishte e tronditur. Luante e nervozuar me pecetën e saj, pastaj filloi të godasë tavolinën me pirunin e saj. - Eja tani, e ke respektuar dhe me tepri madje marrëveshjen që të kujdesesh për mua. Dhe nëse ke pasur këto hezitime, përse nuk the asgjë në shtator, kur të thashë për herë të parë se do të bëja kërkesë për divorc?

Tani ishte radha e Houardit të psherëtinte.

- Erdhe dhe më kërkove edhe një mijë dollarë të tjerë. E ndieja se kisha të drejtë të mësoja se për ç'arsye të duheshin ato para. Nëse do të kishe paratë e tua, do të ma kishe thënë apo thjesht do të më kishte lajmëruar avokati yt?

- Houard, unë nuk kam *avokat*. Punësova një avokat dosido për një mijë dollarë. Ai as nuk e dinte se sa ishin shpenzimet e gjyqit. Fillimisht më tha njëqind, pastaj tha treqind. E kam fjalën për të gjithë çështjen, prandaj doja që t'i shihje edhe ti.

- Nuk mund të bëj asgjë për këtë gjë tani, - ia ktheu Houardi duke shtyrë në një cep dosjen e verdhë. U kollit për të pastruar fytyrën dhe vazhdoi: - Është shumë e rëndësishme për mua që të jesh mirë. Të jesh e sigurt, - shtoi.

- Houard, jam mirë, jam e sigurt. - Kristina buzëqeshi dhe vazhdoi: - I vetmi moment kur nuk ndihem e sigurt është kur skuadra kundërshtarë përpiqet të më ngarkojë me faulle në fushë.

- Dhe sa shpesh ndodh kjo gjë?

- Vazhdimisht.

- Vazhdon të të pëlqejë basketbolli?

- Po tallesh me mua? Ai është shpëtim për mua. Arrita një rekord pikësh në ndeshjen miqësore me Cornell-in javën e kaluar.

- Buzëqeshi e kënaqur.

- Ende nuk e di sesi ndodhi kjo... që ti të luash basketboll.

Duke ngritur supet, Kristina iu përgjigj:

- Ashtu siç ndodh çdo gjë. Providenca Hyjnore. Shkolla ku më dërgove. Ishte e vetmja skuadër dinjitoze sportive që kishin.

- Ah, jo, - ia bëri Houardi, duke kruar kokën. - Mos vazhdo më me filozofira.

Kristina, me gojën plot me kek, i tha një nga thëniet e jetës së filozofit britanik Bertrand Rusëll për filozofinë.

- Teksa rritesha, filloi të më interesojë gjithnjë e më tepër filozofia, për të cilën familja ime kishte hezitime të mëdha. Sa herë që diskutimet vinin te kjo temë, më tallnin. Në fillim më dukej argëtuese, derisa pushova së konsideruari këtë temë si argëtuese.

Me një vështrim të përqendruar dhe thuajse duke buzëqeshur, Houardi i tha:

- Po unë, pushova së argëtuari ty?

- Ende jo, Houard, - iu përgjigj Kristina duke buzëqeshur.

Po qëndronin të dy të heshtur.

- A të mbetet kohë për të studiuar për degën tënde?

- Po studioj në dy degë. Po, e vetmja që nuk më mungon është koha, - tha Kristina. Në kontrast me Xhimin që studionte në dy degë sepse i kishte vënë vetes qëllim të bënte karrierë dhe të pasurohej, Kristina studionte në dy degë ngaqë përtonte, ngaqë synonte të mbushte mendjen e saj abstrakte, me mendimet serioze të të tjerëve, në mënyrë që gradualisht të çlirohej nga mendimet e veta, ato të fluturonin dhe të shkonin larg, synonte që t'i mbante vazhdimisht me punë mendjen dhe duart e saj, kështu që të mos i mbetej kohë gjatë ditës t'u dorëzohej tundimeve.

- Si është Xhimi?

- Mirë. Sivjet është kryeredaktor i gazetës *Review* të kolegjit të Darmuthit.

- Aha! - Houardi buzëqeshi lehtë... - Të vlerëson me "nota" të mira?

- Jo, - ia bëri ajo gjoja e nervozuar. - Është më i ashpër me mua se me çdo person tjetër. Thotë se gazeta kërkon jashtëzakonisht shumë punë. Mezi po pret që të mbarojë studimet.

- Çfarë dëshiron të bëhet pasi të mbarojë studimet?

- Do të vazhdojë studimet pasuniversitare për drejtësi.

- Teksa i përgjigjej, u përpoq të mos e shprehte krenarinë që ndiente, por nuk ia doli. - Dëshiron të bëhet gjykatës, anëtar i Gjykatës së Lartë.

Me sa dukej, Houardit nuk i bënë ndonjë përshtypje këto fjalë.

- I lumtë! Po ti?

- Unë? Thjesht të diplomohem. - Kjo ishte e vetmja gjë që mendonte tani së fundmi Kristina. - Çfarë tjetër mund të ketë për të bërë?

Houardi buzëqeshi.

- Nuk e di. Të gjeje ndonjë punë?

- Houard, të lutem! Ky është një koleg artesh të lira. Ti mendon se jam e kualifikuar për të bërë çdo gjë? Të vetmen gjë që dimë, është të jemi lexues të mirë. Ia themi dhe për kompjuter, por kjo është e gjitha.

- Por një ditë do të të duhet të fillosh një punë.

Ajo shfryu në mënyrë përbuzëse.

- Të lutem! Për ç'arsye? Dhe ku? Me këto që studioj, çfarë do të mund të bëj?

- Nuk e di, - i zgjati fjalët Houardi.

- Çfarë bëjnë ata që studiojnë për filozofi dhe teologji?

- Natyrisht që japin mësim, - iu përgjigj e gëzuar Kristina. - Japin mësim për filozofi dhe teologji.

Houardi buzëqeshi. Kristina ia ktheu buzëqeshjen. Do t'i mungonte.

Kristina pati ndjesinë se Houardi dëshironte ta pyeste për diçka. Ai rrudhi buzët dhe mori atë pamje serioze që merrte sa herë përballej me pyetje të vështira. Dhe kishte kaq shumë pyetje të vështira! Zakonisht, Houardi u shmangej këtyre pyetjeve, por sot po bënte luftë me veten. Në fund vendosi të tregohej i rezervuar. Gjithmonë kjo ndjesi fitonte në fund. Kristina dëshironte ta surprizonte Houardin, qoftë edhe një herë, dhe t'u përgjigjej atyre pyetjeve që ai nuk ia bënte, por sot diçka e tillë nuk do të kishte kuptim. Gjyshja kishte vdekur. Houardi dhe ajo ishin tashmë

zyrtarisht të divorcuar. Dhe nesër do të festonte ditëlindjen e saj të njëzetënjë-të.

- Si është ai, si e quajnë... Alberti?

- Shumë mirë është, - iu përgjigj shpejt Kristina. - Të gjithë shumë mirë janë.

- Çfarë dëshiron të bëjë pas studimeve?

- Nuk jam e sigurt. Ngriti supet duke treguar se nuk i interesonte.

- Nga ato që thotë ai vetë, dëshiron të bëhet gazetar sportiv.

- Gazetar sportiv?

- Po, por sa keq që nuk di të shkruajë.

- E kuptova.

- Ose peshkatar. - Kristina tundi kokën.

Houardi pyeti me një ton të ngadaltë:

- A di të peshkojë ai?

- Besoj, - iu përgjigj Kristina duke u përpjekur të tregohej e gëzuar.

- Ndoqi një prej shkollave më të mira të vendit që të bëhet peshkatar?

- Një peshkatar shumë i zoti, - ia bëri Kristina duke u përpjekur të ndërronte temën e bisedës.

Houardi qëndronte i heshtur.

- Do të martohesh me Xhimin?

Kristina buzëqeshi e trishtuar.

- Nuk e di nëse ai dëshiron të martohet me *mua*.

- Natyrisht që dëshiron.

Kristina tundi kokën në shenjë mohimi.

- Jo. Nuk e besoj.

Houardi po e vështronte me kujdes.

- Je shumë i shqetësuar, - i tha Kristina.

- Jam në ankth për ty, - iu përgjigj ai.

- Shikomë, - ia bëri ajo me entuziazëm. - Jam shumë mirë.

- Po, - ia bëri, por nuk dukej se ishte i bindur. U ngrit. - Eja të ikim.

- Nuk mund ta kaloj ditën në shoqëri me ty, Houard, - ia bëri Kristina me një mënyrë, thua se po kërkonte falje.